



VENDOSI:

1. Krijimin, funksionimin, administrimin dhe monitorimin e Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK) dhe publikimin e tij në formën e një portali elektronik, faqeje *web-i*, me adresë elektronike: <http://www.konsultimi publik.gov.al>.

2. Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike drejton procesin e krijimit, funksionimit, administrimit dhe monitorimit të vazhdueshëm të Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.

3. Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike do të hostohet në serverat e Agjencisë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI).

4. Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike përfshin:

a) si të dhëna parësore, të gjitha njoftimet dhe projektaktet që publikohen për herë të parë në RENJK, siç përcaktohet në pikën 9, të këtij vendimi;

b) si të dhëna dytësore, të gjitha projektaktet që tërhiqen nga databaza e organit publik ku janë të publikuara për herë të parë sipas legjislacionit të posaçëm/sektorial të funksionimit të organit publik.

5. Të gjitha organet publike të ngarkuara për zbatimin e ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, janë dhënës të informacionit për Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.

6. AKSHI, si autoritet rregullues e koordinator për bazat e të dhënave shtetërore, rast pas rasti, përcakton shkallën e ndërveprimit me bazat e tjera të të dhënave për publikimin e projektakteve.

7. Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike ofron akses të hapur dhe pa pagesë për informim, printim dhe ripërdorim të dokumenteve të publikuara në të për të gjithë përdoruesit, grupet e interesit.

8. Të gjitha organet publike të ngarkuara për zbatimin e ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, kanë akses në hedhjen dhe editimin e të dhënave respektive në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike dhe mbajnë përgjegjësi për përmbajtjen e informacionit të publikuar prej tyre.

VENDIM
Nr. 828, datë 7.10.2015

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË
KRIJIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË
REGJISTRIT ELEKTRONIK PËR
NJOFTIMET DHE KONSULTIMET
PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave



9. Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike përmban në bazën e tij të të dhënave:

a) të gjitha projektdokumentet strategjike, kombëtare dhe vendore, si dhe të politikave me interes të lartë publik;

b) të gjitha projektaktet, njoftimet për konsultim dhe të dhënat e lidhura me konsultimin e projektakteve;

c) planet vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmarrjes, në kuptim të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”;

ç) informacionin në lidhje me procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projektaktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimi i debateve publike e deri te miratimi i aktit përfundimtar.

10. Të gjitha projektaktet në faqen *web* duhet të jenë të plota. Çdo projektakt duhet të publikohet si një dosje/*file* e veçantë në format elektronik të përshtatshëm, për t’u ruajtur, shkarkuar dhe ripërdorur sipas rregullores së miratuar nga AKSHI për të dhëna të hapura.

11. Çdo organ publik i ngarkuar për zbatimin e ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, duhet të caktojë një punonjës të administratës, përgjegjës për të grumbulluar, sistemuar, përshtatur dhe hedhur në formatin e duhur, në faqen e *web*-it, të gjitha projektaktet e iniciuara nga të gjitha strukturat dhe departamentet e institucionit përkatës, si edhe për të bërë përditësimin e vazhdueshëm të regjistrit. Kjo detyrë duhet të përfshihet në përshkrimin e punës së personit të caktuar.

12. Personi i caktuar nga çdo organ publik ka detyrimin për të pasqyruar të dhënat e kërkuara në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, jo më vonë se 48 orë nga momenti i miratimit të dokumentit nga organi publik, përveçse kur me urdhër të organit publik ose nisur nga natyra e informacionit, regjistrimi duhet të kryhet brenda një afati më të shkurtër.

13. Personi i caktuar nga çdo organ publik duhet të pajiset nga administratori i Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike me emrin e përdoruesit “*user name*” dhe fjalëkalimin “*password*”, si dhe me manualet për hedhjen e të dhënave në sistem, operimin, përdorimin e faqes *web* etj.

14. Çdo organ publik, që përfshihet në hedhjen e projektakteve në <http://www.konsultimipublik.gov.al>, është përgjegjës për tërësinë dhe llojshmërinë e akteve të hedhura, cilësinë, integritetin, formatin dhe renditjen hierarkike dhe lidhjen e akteve ndërmjet tyre, vendosjen sipas fushës së veprimtarisë, institucionit etj.

15. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) është përgjegjës për hostimin e Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike dhe garanton funksionimin në mënyrë të vazhdueshme të tij, mbrojtjen nga viruset dhe sulmet e ndryshme të kësaj faqeje dhe informacionit që gjendet në të, kryerjen periodike të *back-up*-it etj. AKSHI, sipas nevojave, përgjigjet dhe për zhvillimin periodik të RENJK-së.

16. Deri në krijimin dhe bërjen funksional të Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, konsultimi sipas përcaktimeve të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, bëhet përmes faqes zyrtare të çdo institucioni.

17. Ngarkohen ministri për Inovacionin dhe Administratën Publike, të gjitha organet publike të ngarkuara për zbatimin e ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, si dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama